

## KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 03/08/2023, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

**SHITËSE: Z. Arjan HANA**, lindur më 11.06.1979, në Tiranë, shtetas Shqiptar, me adresë Rruga: Hiqmet Buzi, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: H90611123S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**),

DHE

**BLERËSI: Shoqërisë TEOREN shpk**, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT K51407506E, me seli në adresën Durrës Borake, km 15, në krah të Autostradës Durrës - Tiranë, përfaqësuar nga administratori **Orest Çelo**, i datëlindjes 16.09.1983 identifikuar me letërnjoftimin ID me numër personal I30916008C (në cilësinë e **Blerësit**).

**OBJEKTI:** Shitja e 259,100 (dyqind e pesëdhjetë e nentë mijë e njëqind) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Arjan HANA** dhe blerja e tyre nga shoqëria **TEOREN shpk**.

### **PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal NR. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

### **ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS**

Palët kanë rënë dakord që 259,100 (dyqind e pesëdhjetë e nentë mijë e njëqind) aksione të shiten me çmimin 50.000.082 leke (pesëdhjetë milion e tetëdhjetë e dy) leke.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

### **MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE**

**Shitësi** është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 259,100 (dyqind e pesëdhjetë e nentë mijë e njëqind) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 50.000.082 leke (pesëdhjetë milion e tetëdhjetë e dy) leke nga ana e Blerësit shoqëria **TEOREN shpk**, në llogarinë e Shitësit **Arjan Hana**.

## **KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA**

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

## **LIGJI I ZBATUESHËM**

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

## **TË TJERA**

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

## **SHITËSI**

**Z. Arjan HANA**

*Arjan Hana*  
*[Signature]*

## **BLERËSI**

**Shoqëria TEOREN shpk**

Përfaqësuar nga

**Administratori**

**Orest ÇELO**



*Orest Çelo*  
*[Signature]*